



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PERMET

Adresa: Shetitortja "Abdyl Frasherit" Permet, Gjirokaster, Albania Web: www.bashkiapermet.gov.al, Email : info@bashkiapermet.gov.al

RAPORTI I TRANSPARENCES

Sot më datë 14 shtator 2022, në orën 11:00 u zhvillua takimi i konsultimit publik në Bashkinë e Përmetit, në kuadër të implementimit të Rregullores për Menaxhimin e Mbetjeve. Në takim ishin të pranishëm Kryetarja e Bashkisë së Përmetit znj. Mira Hoxha, Nënkryetari z. Florand Hasani, Përgjegjësi i Sektorit të Pastrim Gjelbërimit Petraq Vangjeli, Punonjësi i Shërbimeve z. Arjan Jaupi, Drejtori Ekzekutiv i INFOCIP z. Gerti Shella, Eksperti për Pushtetin Vendor z. Evis Dosti, znj. Blerina Serjani si edhe përfaqësues të bizneseve të qytetit.

Takimi u drejtua nga Kryetarja e Bashkisë znj. Mira Hoxha, e cila pas falënderimeve të rastit, u ndal tek problematikat konkrete me të cilat ndeshet qyteti i Përmetit sa i takon mbetjeve. Ajo u shpreh se megjithëse nga vizitorët vendas dhe të huaj, dëgjon të vlerësohet puna e arritur me mbajtjen pastër të qytetit që drejton, ka shumë për të bërë dhe një përmetar tha ajo nuk mund të kënaqet me pak. Znj. Hoxha tha se është me rëndësi që qyteti të ketë një Rregullore të dedikuar për Menaxhimin e Mbetjeve që do të jetë në funksion të gjithë procesit. Përmendi po ashtu edhe Marrëveshjen e fimosur së fundmi me Ambasadën e Japonisë në Shqipëri, për blerjen e mjetit teknologjik për pastrimin e mbetjeve si edhe një numër të konsiderueshëm koshash mekanik për hedhjen e tyre. Gjithashtu Bashkia tha Kryetarja, ka aplikuar edhe në një projekt tjetër me CESVI për të cilën Bashkia e Përmetit është shpallur fituese, për të blerë po ashtu edhe një mjet teknologjik tjetër bashkë me koshat, e që do t'i vijë në ndihmë mirëmbajtjes së qytetit.

Punonjësi i Shërbimeve në Bashkinë e Përmetit z. Arjan Jaupi prezantoi shkurtimisht Planin e Veprimit për Menaxhimin e Mbetjeve në formatin power point për të pranishmit, në mënyrë që të krijonte një ide paraprake dhe të linte hapësira për pyetje e sugjerime nga grupet e interesit. Aktualisht sektori i mbetjeve mbulohet nga Sektori i Pastrimit në Bashki. Mbetjetet depozitohen provizorisht në Piskovë. Vend-depozitimi përfundimtar është menduar vendi i quajtur Bajkaj. Duhet patur parasysh tha ai, se procesi për menaxhimin e mbetjeve ka disa faza: Parandalim, Reduktim, Rikuperim, Riciklim, Ripërdorim, Depozitim. Grupi i punës ka tre muaj që po punon për hartimin kësaj rregulloreje. Po mendohet tha ai që ky proces t'i kalojë edhe privatit, por momentalisht është në menaxhim të Bashkisë. Për qëllim të hartimit të rregullores është marrë si shëmbull Bashkia e Lezhës, e cila ka pasur rezultat në këtë proces. Megjithatë u shpreh ai, në si grup pune jemi të hapur të diskutojmë me ju dhe presim komentet tuaja.

Perfaqësuesit e Bizneseve luajtën rol aktiv duke dhënë sugjerime mbi mbarëvajtjen e procesit i cili jo vetëm të ishte funksional por edhe të mund të përshtatej me fasha të ndryshme orari. Ata ishin shumë bashkëpunues dhe madje një pjesë e tyre u zotuan që të merrnin përsipër “ edukimin “ e punëtorëve të tyre. Kjo konsiston me ndarjen mbetjeve që në burim, duke bërë kështu një ndarje paraprake (në mbetje ushqimore, plastike etj). Megjithëse nuk pati një konsensus nga të gjithë të pranishmit që ishin përfaqësues të sektorit privat.

Depozitimet e mbetjeve ishte një tjetër shqetësim i ngritur nga stafi i Bashkisë por që iu bashkuan edhe përfaqësuesit e bizneseve. Sipas tyre duhet të ketë shtim të pikave ku depozitohen mbetjet, pasi përgjatë muajve të verës ku fluksi i turistëve është më i lartë, sasia e mbetjeve shtohet.

Orari i grumbullimit të mbetjeve ishte gjithashtu në vëmendje të diskutimeve konstruktive të palëve, për të cilën u sugjerua të kishte tashmë dy fasha orare të kombinuara këto edhe me familjarët. Vlen të nënvizohet shqetësimi i Kryetarës Hoxha mbi fenomenin e lënies së mbetjeve mbi kapakët e koshave ose përbrë tyre, duke bërë të krijohet aromë e pakëndshme përreth. Duhet filluar tha ajo, ndërgjegjësimi që në familje. Të edukohen brezat e rinj se hedhja e mbetjeve në vendet e dedikuara për to, është detyrë qytetare dhe jo “turp”. Fillimisht Oraret e sugjeruara ishin 15:00-17:00 dhe 20:00 - 24:00 për bizneset, e ndërsa për familjarët u dha opsioni i orës 19:00- 22:00. Megjithëse në vijim ky opsion i ndarë u hodh poshtë duke u dakordësuar për të operuar me të njëjtat fasha orare si për bizneset ashtu edhe për familjarët.

Në këtë pikë të diskutimit z. Shella, i përgëzoi të pranishmit për qytetarinë e treguar, bisedën e qetë dhe frymën bashkëpunuese me të cilën po e trajtonin këtë çështje. Ai hodhi si ide se Qendra që drejton është e gatshme të japë kontributin e saj në këtë drejtim, duke bërë të mundur që brenda zarfave të faturave të energjisë elektrike apo të atij të ujit, të bashkëlidhet edhe një fletë informuese mbi oraret, vend-depozitimet e mbetjeve, pasojat në mjedis etj. Kjo fletë palosje informuese do të jetë në funksion të ndërgjegjësimit të qytetarëve. Fleta informuese tha ai, mundet edhe të jetë në formatin e një posteri, i cili të mund të ngjitet në vend të dukshëm për të nxitur kuriozitetin e qytetarëve. Pastërtia tha ai, është ‘brand-i’ i qytetit të Përmetit, është traditë e ndërtuar ndër vite duke shprehur edhe një herë përgëzimet e tij.

Ndër të tjerash u sugjerua që meqënëse data 17 shtator shënon Ditën Botërore të Pastrimit të mund të organizohej ndonjë aktivitet nga Bashkia i cili do të kishte si qëllim ndërgjegjësimin e qytetarëve në përgjithësi dhe brezave të rinj në veçanti.

Takimi u zhvillua nën një frymë shumë positive, bashkëpunuese duke vërtetuar edhe një herë qytetarinë e këtij qyteti. Në përfundim të takimit stafi i Bashkisë si edhe grupet e interes të pranishëm në takim, ranë dakord që :

- 1- Fashat orare për pastrimin e qytetit do të ishin të njëjta si për bizneset ashtu edhe për familjarët. Fashat oraret të grumbullimit të mbetjeve u caktuan 15:00-17:00 dhe 21:00-24:00.

Hartoi dhe mbajti këtë Raport

Emer Mbiemer : Edjon Maliqi- Bashkia Permet.

